



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Rr.Zija Shemsiu pn., 60000, Gjilan, Republika e Kosovës
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Ref. nr.02/442 Dt.31/03 /2017

RAPORTI I BUXHETIT

01.01.2016-31.12.2016

Për: Akademik Fejzullah Krasniqi, Kryetar i Këshillit Drejtues

CC: Prof.Ass.Dr. Naim Mustafa, Prorektor për Buxhet dhe Financa
Mr.Vaxhid Sadriu, Sekretar i Përgjithshëm i UKZ-së

Nga: Prof. Asoc.Dr. Bajram Kosumi, Rektor

Lënda: **Raporti i shpenzimeve Janar-Dhjetor, 2016**

Përmbajtja

Hyrje.....	3
1. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël	3
1.1. Baza e përgatitjes së raportit	3
1.2. Politikat e kontabilitetit	3
1.3. Subjekti raportues.....	4
2. Kategoritë kryesore të buxhetit	8
2.1. Paga dhe Shtesa	8
2.2. Mallra dhe Shërbime.....	9
2.3. Shpenzimet komunale	11
2.4. Subvencionet	12
2.5. Mjetet kapitale.....	12
3. Të hyrat vetanake	14
4. Konkluzion.....	16
5. Shtojca.....	16
5.1. Plani i Buxhetit të vitit 2016.....	16
5.2. Rrjedha e parasë së vitit 2016.....	16
5.3. Këkesa për rishikimin e buxhetit të vitit 2016	16

Hyrje

1. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

1.1. Baza e përgatitjes së raportit

Raporti është përgatitur në pajtim me Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Nr.03/L-048) dhe Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit (Nr.03/L-048) për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Nr. 03/L-221), neni 46 dhe Ligjit (Nr. 04/L-116) për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit (Nr. 03/L-048) për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin (Nr.03/L-221), dhe SNKSP e bazuar në para të gatshme – *Raportimi Financiar sipas parimit të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.*

1.2. Politikat e kontabilitetit

Baza e kontabilitetit dhe raportimit në Qeverinë e Republikës së Kosovës sipas LMFPP është baza e parasë së gatshme. Në këtë bazë, informatat e prezantuara në këtë raport paraqesin pranimet dhe pagesat e parasë së gatshme.

Menaxhimi i parasë është organizuar në formën e llogarisë së vetme të Thesarit. Llogaria e vetme e Thesarit është sistem llogarish bankare që shfrytëzohen për mbledhjen e të hyrave dhe realizim të shpenzimeve, të cilat i kontrollojnë një institucion i vetëm – Thesari.

Pranimet (të hyrat) njihen atëherë kur janë nën kontroll të Qeverisë. Kjo. Përfshinë paratë të cilat janë transferuar në llogari të Thesarit në BQK, paratë që qëndrojnë në llogari nëpër banka komerciale në pritje për t'u transferuar në llogarinë e Thesarit në BQK dhe paratë e grumbulluara nga zyrtarët e një organizate buxhetore në pritje për tu transferuar në llogarinë e Thesarit në BQK.

Pagesat (shpenzimet) njihen atëherë kur ato paguhen nga llogaria e vetme e Thesarit.

Politikat kontabël janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme gjatë tërë periudhës.

1.3. Subjekti raportues

Raporti financiar paraqet aktivitetin financiar të Qeverisë së Kosovës ashtu siç është specifikuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (03/L-048) ku përfshihen të gjitha **organizatat buxhetore**, MASHT-i, si dhe nën-program i saj, **Universiteti “Kadri Zeka”, Gjilan**.

Universiteti “Kadri Zeka” përbëhet prej katër njesive akademike:

1. Fakulteti i Edukimit
2. Fakulteti Juridik
3. Fakulteti Ekonomik dhe
4. Fakulteti i Shkencave Kompjuterike

Fakultetet e Universitetit janë të ndara në departamente në kuadër të kornizës institucionale të Universitetit. Të gjitha Fakultetet ofrojnë studime të rregullta të nivelit bachelor në përputhje me dispozitat e statutit të Universitetit.

Buxheti i UKZ-së është i ndarë në mënyrë Institucionale, në të cilin janë të përfshira të gjitha njesitë akademike. Në tabelën e mëposhtme është i paraqitur buxheti i lejuar në fillim të vitit fiskal, buxheti pas procesit të rishikimit si dhe prerjen e buxhetit më 31.12.2016.

Table 1


Kategoritë Ekonomike	Buxheti i lejuar 2016	Buxheti pas Rishikimit 2016	Buxheti më 31.12.2016
Paga dhe Shtesa	733,035.00 €	1,023,035.00€	869,468.81 €
Mallra dhe Sherbime	316,339.00 €	246,151.00 €	246,151.00 €
Shpenzime Komunale	50,000.00 €	50,000.00 €	50,000.00 €
Subvencione dhe Transfere	10,000.00 €	10,000.00 €	10,000.00 €
Pasuritë jo financiare(Kapitale)	320,000.00 €	149,800.00 €	147,844.00 €
Totali	1,429,374.00€	1,478,986.00€	1,323,463.81 €

Në tabelën nr. 2 është i paraqitur buxheti dhe shpenzimet më 31.12.2016 si dhe struktura e shpenzimeve në raport me buxhetin total:

Table 2

Kategoritë Ekonomike	Buxheti më 31.12.2016	Shpenzimet 31.12.2016	Pjesëmarrja në % e shpenzimeve sipas kategorive në buxhetin total
Paga dhe Shtesa	869,468.81 €	869,468.81 €	100.00%
Mallra dhe Sherbime	246,151.00 €	222,662.41 €	90.46%
Shpenzime Komunale	50,000.00 €	16,583.88 €	33.17%
Subvencione dhe Transfere	10,000.00 €	8,325.00 €	83.25%
Pasuritë jo financiare(Kapitale)	147,844.00 €	58,287.94 €	39.43%
Totali	1,323,463.81 €	1,175,328.04	88.81%

Në vijim, do të paraqesim pasqyrën grafike të buxhetit dhe realizimit të tij për periudhën raportuese:



Duke u bazuar në tabelën e mësipërme dhe në nevojat që ka UKZ-ja, alokimi i këtij buxheti është si në vijim:

Table 3

Kategoritë Ekonomike	Buxheti më 31.12.2016	Alokimi i Buxhetit	Përqindja e buxhetit të alokuar
Paga dhe Shtesa	869,468.81 €	869,468.81 €	100.00%
Mallra dhe Sherbime	246,151.00 €	246,151.00 €	100.00%
Shpenzime Komunale	50,000.00 €	49,999.96 €	100.00%
Subvencione dhe Transfere	10,000.00 €	10,000.00 €	100.00%
Pasuritë jo financiare(Kapitale)	147,844.00 €	147,844.00 €	100.00%
Totali	1,323,463.81 €	1,323,463.77	100.00%

Nga tabela e mësipërme shihet se buxheti në total është alokuar në lartësinë prej 100%. Ky alokim i buxhetit ka ndodhur për këto arsye:

- **Alokimi i pagave** është bërë në masën 100.00% të buxhetit total për këtë kategori.
- **Mallrat dhe shërbimet:** janë alokuar në masën 100.00%. Përmes kësaj kategorie UKZ-ja paguan shpenzimet fikse ashtu edhe ato variabile si psh. Kontratat për pastrimin-mirëmbajtjen e objektit, pagesa për sigurimin fizik, mirëmbajtja e sistemeve elektronike, shërbimet kontraktuale, pagesa e mbushjeve të telefonave mobil, avanset për udhëtime zyrtare etj.
- **Shpenzimet komunale** janë alokuar duke u bazuar në shpenzimet e vitit paraprak si dhe në përpjestim mujor 1/12 për vitin aktual. Të gjitha pagesat realizohen përmes faturave. Këty hyjnë të gjitha pagesat xhiro si: Pagesa e energjisë elektrike, pagesa e ujësjellësit, pagesa për mbeturina si dhe pagesa për telefona fiks. Shpenzimet komunale për 9 muor janë alokuar 100.00%.
- **Transferimet dhe subvencionet,** alokimi është bërë në masën 100.00%, pasi që në këtë kategori është bërë pagesa e bursave studentore. Kemi mungesë të mjeteve në këtë kategori.
- **Alokimi i Investimeve kapitale,** është bërë në masën 100.00%, sipas planit të rrjedhës së parasë. Mjetet kanë qenë në dispozicion për zhvillimin e proceduarave të prokurimit për: renovimin e objektit të UKZ-së, për furnizim me paisje në fushën e Teknologjisë Informative si dhe një pjesë më e vogël për furnizim me mobilje.

Më poshtë kemi paraqitur alokimin 12 mujor të buxhetit në raport me shpenzimet e kësaj periudhe si dhe raportin e shpenzimeve 12 mujore me buxhetin në tërësi:

Table 4

Kategoritë Ekonomike	Buxheti më 31.12.2016	Alokimet 31.12.2016	Shpenzimi 31.12.2016	Shpenzimet në raport me alokimin 12 mujor (në %)	Shpenzimit në raport me buxhetin vjetor (në %)
Paga dhe Shtesa	869,468.81€	869,468.81€	869,468.81€	100.00%	100.00%
Mallra dhe Sherbime	246,151.00€	246,151.00€	222,662.41€	90.46%	90.46%
Shpenzime Komunale	50,000.00€	49,999.96€	16,583.88€	33.17%	33.17%
Subvencione dhe Transfere	10,000.00€	10,000.00€	8,325.00€	83.25%	83.25%
Pasuritë jo financiare(Kapitale)	147,844.00€	147,844.00€	58,287.94€	39.43%	39.43%
Totali	1,323,463.81€	1,323,463.77€	1,175,328.04€	88.81%	88.81%

Pra, Universiteti “Kadri Zeka”, gjatë periudhës raportuese, e ka shpenzuar buxhetin e alokuar për 12 mujor në masën prej 88.81% dhe gjithashtu buxhetin e përgjithshëm vjetor në masën 88.81%.

2. Kategoritë kryesore të buxhetit

2.1. Paga dhe Shtesa

Në kategorinë Paga dhe shtesa, për periudhën raportuese 12 mujore, janë shpenzuar gjithsej 869,468.81€. Për të mbuluar diferencën e deficitit (mungesës) së pagave janë përdorur edhe mjete nga të hyrat vetanake në shumë prej 13,860.00 Eur. Totali i shpenzimit në paga për vitin 2016 është 883,328.81. Këtu përfshihen pagesa neto e pagave, honorareve, mbinormave, pagesa për kontribute pensionale 5% si dhe pagesa e tatimit të ndalur në burim për të gjithë punonjësit e rregullt të UKZ-së. Vlenë të theksojmë që në këtë kategori nuk përfshihen punonjësit me kontratë për shërbime të veçanta dhe të gjitha pagesat tjera për punonjës jashtë listës – sistemit qeveritar të pagesave (Pay roll).

Table 5

Përshkrimi	Shpenzimi i pagave nga BKK
Neto pagat	735,368.88€
Pagesa e kontributit pensional nga punëdhënësi	41,006.11€
Pagesa e kontributit pensional nga i punësuari	41,006.11€
Tatimi në të hyra personale	65,947.71€
Subtotali	883,328.81€
Barazimi nga të hyrat	-13,860.00
Totali	869,468.81

2.2. Mallra dhe Shërbime


Në kategorinë Mallra dhe Shërbime, për periudhën raportuese 12 mujore, janë shpenzuar gjithsej 222,662.41€.

Table 6

Kategoria e shpenzimit	Totali	%
Shërbimet e telekomunikimit - Vala	9,202.81€	4.13%
Shërbimet e internetit IPKO	490.05€	0.22%
Shp. e udhëtimit jashtë vendit	8,465.96€	3.80%
Shpenzimet e udhëtimit	294.00€	0.13%
Shërbimet kontraktuale	9,601.56€	4.31%
Shërbime teknike	7,246.32€	3.25%
Kompjuter-Laptop	18,858.44€	8.47%
Pajisjet tjera (IT etj.)	19,463.32€	8.74%
Furnizim për zyrë	6,506.35€	2.92%
Karburant për ngrohje	47,879.43€	21.50%
Karburant për vetura	1,776.07€	0.80%
Shërbimet e Sigurimit	15,257.87€	6.85%
Mirëmbajtja e objektit (pastrimi)	33,914.46€	15.23%
Shpenzimet e reprezentacionit	9,221.39€	4.14%
Shpenzimet për akreditim dhe anëtarësim	19,260.00€	8.65%
Shpenzimet tjera	15,224.38€	6.84%
Totali	222,662.41€	100.00%

Në vijim, paraqitja grafike në bazë të përqindjes e kategorive kryesore në mallra dhe shërbime:

Totali- Mallra dhe Shërbime




2.3. Shpenzimet komunale

Me buxhetin e vitit 2016 shpenzimet komunale janë shpenzuar në bazë të faturave dhe përbëjnë shpenzime që ndodhin çdo vit, thuajse në masën e njëjte, pa ndryshime të mëdha. Prandaj, në vijim është paraqitur tabela me shpenzime për secilin operator ekonomik.

Table 7

Kategoria e shpenzimit	Shuma e shpenzuar 31.12.2016
PTK-Telefonia fikse	416.85€
KEDS	11,253.71€
HIDROMORAVA	4,715.41€
Eco-higjiena	886.40€
Totali	16,583.88€



2.4. Subvencionet

Kufinj të buxhetor të përcaktuar nga ana e MASHT-it dhe MF nuk i përmbushin kërkesat dhe nevojat tona si Institucion i Arsimit të Lartë e sidomos në kategorinë e Subvencioneve. Me këtë kategori bëhet pagesa e bursave për studentet e dalluar. Shuma prej 10,000.00 Eur nuk ka qenë e mjaftueshme për mbulimin e të gjitha kërkesave. Për vitin 2016 për të gjitha njesitë akademike janë ndarë vetëm 30 bursa për studentë me një vlerë prej 333.00 € për person.

2.5. Mjetet kapitale

Për vitin 2016, Universiteti “Kadri Zeka” ka pasur në posedim 2 projekte kapitale. Me procesin e rishikimit të buxhetit kemi pasur një projekt shtesë për shpenzime në fushën e Teknologjisë Informative në shumë prej 110,000.00 Eur, ku numri i përgjithshëm i projekteve kapitale për vitin 2016 është rritur në tre projekte. Pas rishikimit të buxhetit të vitit 2016, kemi pasur një ndryshim-zvoglim të shumës së mjeteve në projektin e “Ndërtimi dhe renovimi i infrastrukturës së UKZ-së” dhe të projektit “Blerje e mobiljeve” në favor të projektit të teknologjisë informative.


Table 8

Nr. Rendor	Projekti	Shuma pas rishikimit 2016	Shuma e shpenzuar 31.12.2016	Struktura në përqindje (%)
1	Ndërtimi dhe renovimi i infrastrukturës së UKZ-së	34,044.00€	34,043.06€	100.00%
2	Blerja e mobiljeve në UKZ	3,800.00€	3,794.88€	99.87%
3	Blerja e paisjeve të Teknologjisë Informative	110,000.00€	20,450.00€ (88,950.00€) ¹	18.59%
	Totali	147,844.00€	58,287.94€	39.43%

Në vijim, paraqitja grafike e shpenzimit të Mjeteve Kapitale në bazë të përqindjes:

¹ Sipas përshkrimit nga MASHT: Bartje e shpenzimit nga projekti 14045 në 10144 kuponi i shp. 2016-456427 Arsyja: projekti 14045 ka qenë i përfshirë në kursime sipas vendimit të qeverisë nr.01/123, dt.28.12.2016: paisje e teknologjisë informative.

Struktura e mjeteve të shpenzimeve kapitale




3. Të hyrat vetanake²

Të hyrat vetanake të UKZ-së janë mjete financiare që grumbullohen duke u bazuar në Ligjin për Buxhetin e Republikës si dhe Ligjin për Arsimin e Lartë në Kosovës. Këto të hyra grumbullohen nga pagesat e studentëve si: Pagesa e semestrit, pagesat e vërtetimeve, pagesat e regjistrimeve etj. Shuma totale e të hyrave gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2016 është **129,875.00 Eur**.

Table 9

	Emri	JANAR 2016	SHKURT 2016	MARS 2016	PRILL 2016	MAJ 2016	DHJETOR 2016	KORRIK 2016	GUSHT 2016	DHJETOR 2016	TETOR 2016	NËNTOR 2016	DHJETOR 2016	TOTALI 31.12.201 6
1	Të hyrat vetanake: participimi i studenteve!	5,873.50€	862.00€	44,795.00€	8,457.50€	850.00€	957.50€	4,415.00€	10.00€	3,459.00€	20,999.00€	30,443.00€	8,757.50€	129,875.00€

² Universiteti "Kadri Zeka" nuk i shfrytëzon - menaxhon të hyrat vetjake.



4. Konkluzion

Marrë në përgjithësi performanca financiare e Universitetit “Kadri Zeka” gjatë vitit 2016 ka qenë e kënaqshme. Problemet më të theksuara janë paraqitur te buxheti i lejuar për kategorinë e pagave dhe medijëve, ku kemi qenë të detyruar që me rishikim të buxhetit të vitit 2016 të shtohen fondet në këtë kategori për mbulimin e diferencës së shpenzimeve aktuale.

Gjithashtu, në kategorinë e subvencioneve kemi pasur mungesë të theksuar të buxhetit duke marrë parasysh faktin që përmes kësaj kategorie bëhet pagesa e bursave dhe mbështjeve financiare për studentët. Për këtë arsye, në nivel institucional, duke përfshirë të gjitha njesitë akademike (Fakultetet) kemi ndarë vetëm 30 bursa për studentët e dalluar me një vlerë minimale prej 333.00 eur.

Me rekrutimin e stafit të ri në Zyren e Financave respektivisht me pavarësimin financiar të UKZ-së nga MASHT-i, mendojmë që do të rritet edhe më tutje performanca financiare e realizimit të buxhetit.

5. Shtojcë

5.1. Plani i Buxhetit të vitit 2016

5.2. Rrjedha e parasë së vitit 2016

5.3. Këkesa për rishikimin e buxhetit të vitit 2016

Zyra për Buxhet dhe Financa
Mr.Valon Kllloqi

Sekretari i Përgjithshëm
Mr.Vaxhid Sadriu,

Prorektori për Buxhet dhe Financa
Prof.Ass.Dr.Naim Mustafa,

Gjilan, dt. 31.12.2016

